

AKT THEMELI
MI I SHOQËRISË ME PËRGGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“AA Tirana Papers ” shpk.

Në Tiranë, sot më datë 23.11.2022, ne të poshteshënuarit

Aleks Lybeshari, e datëlindjes 03.04.1979, lindur ne Duhanas Berat,identifikuar me dokument identifikimi:karte identiteti me numër personal H90403076C:

Aleks Doko e datëlindjes 17.7.1972, lindur ne Kakrukë,identifikuar me dokument identifikimi:karte identiteti me numër personal H20717003B:

me cilësinë e “ortakeve themelues”deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, **“AA Tirana Papers ” shpk.**

Neni 1

Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin**“AA Tirana Papers” shpk,** dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3

Selia

Shoqëria **“AA Tirana Papers” shpk** e ka selinë në adresë:”Rruga Jorgo Panajoti 1001,Ish fabrika e tullave silikate Tirane“dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarise per shoqërine **“AA Tirana Papers” shpk** është “Import,eksport shitje me pakice e shumice te letres dhe nenprodukteve te saj.Perpunim i letres per amballazh”.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 2(dy) kuota

me nga 50,000 lek secila, te cilat zotërohet si më poshtë:

Aleks Lybeshari, e datëlindjes 03.04.1979, lindur ne Duhanas Berat,identifikuar me dokument identifikimi:karte identiteti me numër personal H90403076C, zoteron 1(nje) kuote ose 50 % te kuotave te kompanise.

Aleks Doko e datëlindjes 17.7.1972, lindur ne Kakrukë,identifikuar me dokument identifikimi,karte identiteti me numër personal H20717003B, zoteron 1(nje) kuote ose 50 % te kuotave te kompanise.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".


Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë "AA Tirana Papers" shpk është: Aleks Lybeshari, e datëlindjes 03.04.1979, lindur ne Duhanas Berat, identifikuar me dokument identifikimi: karte identiteti me numër personal H90403076C. Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5 (pesë) vjeçar. Data e emërimit të tij përkon me datën e themelimit të shoqërisë që është data 23.11.2022.

Neni 10

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 11

Dispozita perfundimtare


Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike. Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën per nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare "AA Tirana Papers" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

ORTAKET THEMELUES:

Aleks Lybeshari

Aleks Lybeshari 

Aleks Doko

Aleks Doko 

Tiranë, më datë 23.11.2022